



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:238433
Datë: 24.12.2024
Numri i dokumentit: 06644084

Rev.nr.581/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar Franciska Zhitija -Ymeri dhe Lumni Sallauka, anëtar, në çështjen juridike të paditëses Agjencia për Patundshmëri “P.”, me numër të biznesit, me seli në P., Rr. “....” Bll....., nr....., të cilën e përfaqëson i autorizuari Av. Eset Berisha nga P., kundër të paditurës A. B., nga P., Rr. “...” nr....., për shkak të mos përmbushjes së obligimit – kthimit të borxhit, vlera e kontestit 1500.00 €, duke vendosur sipas revizionit e paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3367/2021, të datës 19.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si pa lejuar revizioni i paditëses, Agjencia për Patundshmëri “P.”, me seli në P.”, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.3367/2021, të datës 19.12.2023.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin C.nr. 465/2014, të datës 29.01.2021, ka vendosur: “I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Agjencia për Patundshmëri “P.”, me numër të biznesit, me seli në P., Rr. “....” Bll....., nr....., me të cilën ka kërkuar që të “detyrohet e paditura A. B. që në emër të kthimit të mjeteve të huazuara t’ia kthejë paditëses shumë prej 1,500.00€, dhe pagesën e interesit sipas mjeteve të depozituara në banka afariste, të

llogaritur nga dita e kalimit të afatit për kthim, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi”. I. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale”.

Gjykatës e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin Ac.nr.3367/2021, të datës 19.12.2023 ka vendosur " Refuzohet e pa bazuar ankesa e paditëses Agjencia për Patundshmëri "P.", me numër të biznesit, me seli në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.465/14, i datës 29.01.2021, vërtetohet ".

Paditësja, përmes të autorizuarit avokat Eset Berisha, ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të aprovohet dhe të priset aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe i gjykatës së shkallës së parë, dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e palës paditëse

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të lejueshmërisë së revizionit sipas nenit 211.2 dhe 221, të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i paditëses është i pa lejuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja në gjykatën e shkallës së parë më datë 12.02.2014, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të mos përmbushjes së detyrimit. Gjykata eshkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve ka mbajtur seancën për shqyrtim kryesor dhe i ka administruar provat e propozuara, si: Marrëveshja për kthimin e borxhit e datës 04.01.2014, Kopjet e komunikimeve e datës 16.05.2018 në rrjetin social Facebook dhe Kopjet e komunikimeve e datës 15.08.2018 dhe 04.01.2019 në rrjetin social Instagram, ka dëgjuar edhe dëshmitarët dhe pas vlerësimit të tyre ka konstatuar gjendjen faktike prej nga ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr. 465/2014, të datës 29.01.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme, duke e marrë parasysh dispozitën e nenit 211.2 të LPK-së, ku parashihet që në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000€, revizioni nuk lejohet, rezulton se nëse marrim parasysh vlerën e kontestit, në kërkesëpadi dhe në dispozitivin e aktgjykimit, e cila është në shumën prej vetëm 1.500.00 €, e që do të thotë nuk kalon limitin prej 3.000€, të paraparë si kusht ligjor për mundësinë e paraqitjes së revizionit, rezulton se revizioni i paditëses, është i pa lejuar dhe është dashur të hedhet.

Pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218 të Ligjit për Procedurën Kontestimore(LPK), Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221, të këtij ligji, është dashur që revizionin të e hedh si të palejueshëm.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim nenin 221, të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.581/2024, datë 18.12.2024

Kryetari i kolegjit,
Beshir Islami